



FOTO: ZHVILLIMI I EKO-TURIZMIT NË ALPET BALLKANIKE (QENDRA PËR MBROJTJEN DHE HULUMTIMIN E ZOGJVE – MAL I ZI/)

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të
Bashkëpunimit ndërkuftar Mal i
Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi -
Kosovë 2014- 2020

Gusht 2021

PËRMBAJTJA

Edicioni i njëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- »»» Thirja e Tretë për projekt propozime brenda Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkuftar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020.....2
- »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri..... 3
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë4
- »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri5
- »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 7
- »»» Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë9

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

гласно информации от Европейского Союза. Содержание является ответственностью Технического Секретариата Программы ИПА БНК Македонија – Словенија и Македонија – Косово 2014-2020 и не представляет официальной позиции Европейского Союза.

* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.



This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



MNE-KOS
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

CBC ZOOM

Thirrja e Tretë për projekt propozime brenda Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri 2014-2020

Qeveria e Malit të Zi – Zyra e Integritimit Evropian dhe Drejtoria e Financës dhe Kontraktimit për Asistencën e Fondeve të BE në Ministrinë e Financave dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë me 29 Qershor të vitit 2021 shpallen Thirrjen e Tretë për dërgimin e projekt propozimeve në kuadër të Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020.

Qellimi i përgjithshëm i kësaj thirrje ishte të promovojë/forcojë marrëdhëniet e mira ndërkufitare dhe zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve kufitare, nëpërmjet valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithpërfshirës, në respekt të trashigimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Fondet në vlerë prej 4.9 milion EUR janë në dispozicion nën këtë thirrje dhe janë të përkushtuar për prioritet tematike në vijim (PT):

- PT1: Inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashigimisë Natyrore;
- PT2: Mbrotja e mjedisit, promovimi i ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tij, menaxhimi dhe parandalimi i rreziqeve;
- PT3: Promovimi i punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale përmes kufirit.



Thirrja ishte e hapur për persona juridikë dhe organizata jofitimprurëse të themeluara në Mal të Zi dhe Shqipëri dhe që u përkasin kategorive të tilla si: qeveritë lokale dhe institucionet e tyre, organizatat e turizmit dhe kulturës, shoqatat e komunave/bashkive, agjencitë e zhvillimit, organizatat lokale të mbështetjes së biznesit, OJQ-të, organet private dhe publike që mbështesin fuqinë punëtore, institucionet e trajnimit profesional dhe teknik, organet dhe organizata për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarfikëseve/emergjencës, shkollat, kolegjet, universitetet dhe qendrat



hulumtuese, duke përfshirë institucionet për trajnim profesional dhe teknik.



Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve ishte data **13 Shtator 2021**.

Më shumë informacion ju mund të shkarkoni [këtu](#).

Publikimi i Thirrjes për Propozime u promovua gjërësisht përmes mediave sociale dhe tradicionale.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Libri i Kuzhinës “Gorska trpeza” fitoi dy çmime në konkursin e publikimit më të mirë të kulinarisë në botë

Libri i kuzhinës “Gorska trpeza” hartuar në kuadër të projektit “Kuzhina lokale si ofertë turistike në rajonin ndërkufitarë” fitoi vendin e 1-rë në kategorinë “Best among the best in the world” në konkursin e publikimit më të mirë të kulinarisë në botë. Pavarësisht situatës së pandemisë, pati konkurrencë të fortë dhe libri fitoi dy çmime dhe mori të drejtën për të përdorur Çertifikatën “Best in the World”. Agjensia për Zhvillimin Rajonal Bjelasica, Komovi dhe Prokletije deklaruan: “Faleminderit partnerëve dhe donatorit që mbështetën këtë përpjekje, BE-së përmes programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri, EBRD/FAO për rajonin Durmitor dhe Ministrinë e Administrimit Publik për bashkfinancimin e dhuruar. Në veçanti falenderojmë gratë që na asistuan dhe që kontribuan që ky botim nga një qoshkë e vogël e botës të tërheqë vëmendjen dhe të meritojë respekt nga ekspertët e gastronomisë botërore!”



Gjeni më shumë informacione mbi projektin dhe vizitoni faqen <http://www.gastro-puka.com/en> dhe

<http://montegastro.me/>.

U mbajt simpoziumi akademik mbi trashigiminë arkeologjike kristiane

Me 4 Gusht u organizua simpoziumi akademik, në kuadër të projektit, “Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit”. Ky simpoziom u mbajt në Hotel Berane dhe bëri bashkë ekspertët të arkeologjisë, historisë dhe të fushave tjera të lidhura me to.



Violeta Foliq nga Muzeu Polimje i Malit të Zi informoi pjesëmarrësit se ky muze është i vetmi institucion në veri të Malit të Zi që është i certifikuar për gërmime arkeologjike.

Ajo deklaroi që gjatë projektit, përveç lidhjeve profesionale



dhe përmirësimit të bashkpunimit, ata krijuan edhe lidhje miqësore të vlerësuara si të rëndësishme për suksesin e projektit. “Kjo garanton vazhdimin e bashkpunimit në të ardhmen kurdo që ketë mundësi” tha ajo.

Në emër të Dioqezës Budimlje dhe Niksiç, Kryepeshkopi **Konstantin Dojiq** foli për rëndësinë e projektit dhe informoi pjesëmarrësit për dy vendet, njëri në Berane dhe tjetri në Shkodër, ku janë bërë gërmime arkeologjike, të cilët janë ruajtur, mbrojtur, promovuar, dhe pajisur me sinjalistikë dhe do të integrohen në ofertën lokale turistike.



Holta Koci, nga organizata shqipëtare Community Assist tha që është shumë e rëndësishme që trashigimija kulturore të prezantohet siç duhet, sidomos tek të rinjtë. Përveç faktit që ekspertët paten mundësi të bashkëpunojnë ngushtë me njëri tjetrin, ky projekt mundësoi edhe informimin më të mirë të qytetarëve. Ajo theksoi se është shumë e nevojshme të punohet për promovimin e këtyre vlerave dhe vendeve.

Nga pjesëmarrësit u theksua që trashigimija kulturore e mbi dy mijëvjeçarëve të Kristianizmit në rajon, përfaqson një burim turistik të rëndësishëm dhe që trashigimija kulturore e përbashkët e dy vendeve duhet ushqyer, promovuar dhe përdorur.

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulimtimin e Zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku". Brenda projektit u organizua një turne në vendet më tërheqëse për gazetarët. Kjo ishte një mundësi ideale për ta që të përjetojnë Alpet Ballkanike nga pikëpamja e turistëve, dhe më pas të përcjellin përshtypjet e tyre përmes mediave.

Për më tepër, gjatë qershorit u mbajt një trajnim mbi bimësinë, bimët mjekësore dhe kërpudhat në Bjeshket e Nemuna.



Në kuadër të të njëjtit projekt u mbajt një trajnim profesional në Gusi për Guidat Malore në bashkëpunim me Shërbimin e Shpëtimit Malor të Malit të Zi. Në trajnim morën pjesë anëtarë nga shumë shoqata anëtare të Federatës së Alpinizmit të Kosovës. Pjesëmarrësit u pajisën me njohuri mbi rregullat e udhëzimit të alpinizmit gjatë ngjitjes, rregullat e sigurisë, orientimin në natyrë, leximin e hartave, pajisjet e nevojshme, ushqimin, etj.




Për më tepër, në Prishtinë më 25 qershor u mbajt një konferencë për shtyp me qëllim prezantimin e potencialit turistik të Bjeshkeve të Nemuna dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm bazuar në trashëgiminë e pashtershme natyrore dhe kulturore të këtij rajoni.

Së fundi, brenda të njëjtit projekt dhe për t'i bërë turistët dhe vizitorët më të sigurt në Bjeshket e Nemuna, gjatë zbatimit të projektit, u rinovuan 68 kilometra shtigje hiking ndërkufitare, u siguruan pajisje të vlefshme për shpëtuesit dhe një dron të vlefshëm me një aparat termik për të lehtësuar kërkimin e njerëzve të humbur në mal, guidat malore u trajnuan dhe Qendra e Shpëtimit është rinovuar.



Ka përfunduar projekti Bjeshkët e Nemuna - destinacion natyror tërheqës

Projekti Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës i zbatuar nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije, Organizata Turistike e Plavës, Agjencia për Zhvillim Rajonal-Perëndim (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës përfundojë me aktivitetet. Një nga rezultatet kryesore të projektit është portali në internet i krijuar që promovon rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar. Portali përmban të gjitha informacionet në lidhje me ofertën kur bëhet fjalë për pushimet aktive, me vendndodhjet, vendet, informacionet, kontaktet, hartat, etj. Për më tepër, gjithashtu u krijua një aplikacion Android dhe iOS, i cili gjithashtu përmbante të njëjtat të dhëna. Për më shumë informacion vizitoni <http://accursed-mountains.me/>.



Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës

Si pjesë e aktiviteteve të projektit të Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës të zbatuar nga Komuna e Andrijeviçës, OJQ Grupi i Veprimt Lokal Gjeravica dhe Unioni i Fermerëve të Malit të Zi Verior ishte prodhuar një dokumentar i shkurtër mbi aktivitetet.

Shikoni dokumentarin [këtu](#).



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri


Liçeni i Shkodrës pa ndotje Kimike - SOLUTION

Projekti "Liçeni i Shkodrës pa ndotje kimike – SOLUTION" zbatohet nga Qendra për kërkime toksikologjike e Malit të Zi, Universiteti i Tiranës dhe Asocioni Green Centre nga Shqipëria. Projekti synon të arrijë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta afatgjata, të realizojë vlerësimin e riskut mjedisorë nga ndotja kimike në liçenin ndërkufitarë të Shkodrës dhe të përcaktojë pikat kryesorë të ndotjes.



Ekipi i projektit është duke e promovuar aktivisht projektin dhe rezultatin që synon të arrijë. Si pjesë e aktiviteteve të projektit është krijuar një webfaqe që përmban të gjitha informacionet dhe që mund të qasen në <http://solutionmne-al.eu/>.

Gjithashtu ky projekt bashkë me thirrjen e 3-të për dërgimin e projekt propozimeve, u promovua në një intervistë në TV. Intervista e plotë mund të ndiqet [këtu](#).



U organizua shpallja dhe kampet rinore në kuadër të projektit "Punë për të Rinjtë"

Projekti "Punë për të Rinjtë" po zbatohet nga Partnerët Shqipëtarë për Zhvillim dhe Ndryshim, Asocioni për Demokraci dhe Prosperitet – Zid dhe shoqata Intelktualët e Rinj – Shpresë. Si pjesë e aktiviteteve të këtij projekti u organizua takimi promovues me datë 11 Qershor të vitit 2021 në Shkodër.



Projekti synon të përmirësojë aftësitë e të rinjve për të krijuar idetë e tyre të biznesit bazuar në aftësitë inovative, kompetencat dhe njohuritë e reja, të rrisë mundësitë e mbështetjes së bizneseve start-up nga të rinjtë e përfshirë në projekt dhe të rrisë mbështetjen ndaj sipërmarrësve dhe të vetpunësuarve të rinj nëpërmjet politikave dhe incentiveve lokale.

Gjatë muajit Korrik të vitit 2021, "Kampi rinor për ndryshim" u organizua në Shkodër. Kampi ishte planifikuar të zhvillonte aftësitë praktike të të rinjve për angazhim në aktivitetet e biznesit dhe sipërmarrjes nëpërmjet përdorimit të qasjeve dhe teknologjive inovative.



Në të njëjtë periudhë, Kampe verore u organizuan edhe në Ulqin. Gjatë ketyre aktiviteteve, pjesëmarrësit patën mundësinë të përgatisin plane biznesi që mund të mbështeen nga projekti në formën e start-up. Kjo u arrit nga puna mentoruese e ekspertëve nga fusha e menaxhimit dhe zhvillimi të biznesit.



A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri

Projekti "A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri" zbatohet nga Caritas i Kryepeshkopatës së Tivarit, Caritas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë (Shqipëri) dhe Asociacion i Paraplegjikëve të Tivarit. Projekti synon të rrisë punësimin e personave me aftësi të kufizuara, të trajnojnë 30 prej tyre nëpërmjet 2000 orëve mentorimi, si dhe t'i ofrojë mundësi punësimi. Ekipi i projektit po e promovon aktivisht planin e aktiviteteve të projektit me fokus grupin e synuar. Koordinator i projektit **Marko Gjelloviq** ndër të tjera dha edhe një intervistë në një stacion televiziv.



Shikoni videon nga intervista [këtu](#).

Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve shqiptarë dhe malazez për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit

Projekti "Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve shqiptarë dhe malazez për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit" po zbatohet nga World Vision Shqipëri, OJQ Horizonti i Ri (Ulqin), Shkolla e mesme e kombinuar "Vëllazërim-bashkim" (Ulqin) dhe shkolla profesionale "Hamdi Bushati" (Shkodër). Projekti synon të pajisë të njëjtë nga Shkodra dhe Ulqini me aftësitë e duhura që të aftësohen për tregun e punës.



Me 20 Qershor 2021 u hap panairi "Youth Fair: Rrugët e zhvillimit të karrierës në sektorin e turizmit" në Shkodër. Të rinjtë nga shkolla profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër dhe Shkolla e mesme e kombinuar "Vëllazërim-bashkim" Ulqin, prezantuan disa nga produktet dhe punët e realizuara nga ata. Qëllimi i panairit ishte që të rinjtë të prezantonin aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe ide për promovimin e turizmit në dy qytetet e tyre. Gjatë panairit të rinjtë patën rastin të krijojnë kontakte me bizneset dhe agjensitë që vizituan aktivitetet. **Erisedi**, 18 vjeç nga Shkodra duke komentuar panairin tha: "Ky panair ishte një eksperiencë e re dhe një hap përpara në zhvillimin e karrierës sime. Këshilla ime për të rinjtë është të marrin pjesë në trajnimet profesionale dhe të ndjekin ëndrrat e tyre".



Si pjesë e promovimit, u prodhua një katalog për prezantimin e destinacioneve turistike në Ulqin. Versioni në gjuhën malazeze është [këtu](#) dhe në gjuhën shqipe është [këtu](#).



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Krijimi i punësimit në bujqësi

Projekti Krijimi i punësimit në bujqësi zbatohet nga Kryeqyteti i Podgoricës - Sekretarijati për ndërmarrjesi dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK.



Si pjesë e aktiviteteve të projektit dhe me qëllim lehtësimin e kultivimit të tokës dhe veçanërisht menaxhimin e kullotave në ngastrat e mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike, partnerët e projektit më 9 gusht 2021 shpërndanë motor kultivues në 20 përfitues të granteve për kultivim në komunat e Pejës dhe Istogut.

PRAXIS

Projekti PRAXIS zbatohet nga Caritas Kosova, Caritas Mali i Zi, QAKP Gjon Nikolle Kazazi - Gjakove dhe Komuna Berane. Projekti synon të mbështesë nxënësit dhe studentët dhe të rinjtë e papunë përmes sesioneve të udhëzimit dhe këshillimit në karrierë.

Më 24 qershor 2021 partnerët e projektit organizuan Rrjetin e parë Ndërkufitar të Punës në Gjakovë dhe mblodhën qytetarë, më shumë se 40 ekspozues nga zona dhe të rinj. Ngjarja kishte për qëllim lidhjen e punëdhënësve dhe të rinjve në rajonin ndërkufitarë.



Më shumë informacion mbi ngjarjen është në dispozicion [këtu](#).



Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara

Projekti Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara zbatohet nga Komuna e Andrijevicës, Komuna e Deçanit dhe Shoqata bjeshkatore dhe apliniste "Shkelzen Haradinaj", Deçan.

Gjatë korrikut partnerët e projektit kontraktuan kompaninë përgjegjëse për punët në ndërtimin e shtëpizës malore në Deçan. Kompania ka filluar me punimet përgatitore dhe punon në terren.



Për më tepër, si pjesë e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve, partnerët e projektit më 6 gusht të vitit 2021 organizuan një trajnim mbi bazat e zhvillimit të alpinizmit në malet e Deçanit.



Transhumance - ofertë e re turistike në Kosovë dhe Mal të Zi

Transhumance – ofertë e re turistike në Kosovë dhe Mal të Zi zbatohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Komuna e Istogut.

Projekti synon mobilizimin e katunëve për ofrimin e shërbimeve në turizëm, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve turistike dhe promovimin e vlerave kulturore, natyrore dhe bujqësore të katunëve. Më 22 korrik të vitit 2021, si pjesë e aktiviteteve të projektit, 15 familje u mbështetën me panele diellore.



Gjegjësisht, përfituesit mbështeten nga sistemet diellore, 6 prej të cilave janë me kapacitet të lartë dhe 9 me kapacitet të ulët. Gjatë ngjarjes partnerët e projektit deklaruan se mbështetja është vendimtare dhe duhet të ndihmojë përfituesit në ofrimin e shërbimeve më të mira, veçanërisht në turizëm. Ata theksuan rëndësinë e motivimit të përfituesve për t'u angazhuar vazhdimisht në ruajtjen e traditës dhe për t'u marrë sa më shumë me shërbimet turistike dhe përmbushjen e kërkesave të turistëve vendas dhe të huaj.

Trashëgimia kulturore - Thesar i rajonit ndërkufitar

Komuna e Pejës dhe Komuna e Gucisë po zbatojnë projektin Trashëgimia kulturore - Thesari i Rajonit Ndërkufitar që synon të mbështesë zhvillimin ekonomik të zonës së projektit i cili bazohet në valorizimin e trashëgimisë së pasur kulturore në rajonin e synuar.




Ceremonia e fillimit të projektit Trashëgimia kulturore - Thesari i rajonit ndërkufitar u mbajt në Pejë më 16 korrik të vitit 2021. Në ceremoni morën pjesë zëvendësministri i MAPL -së, **Avdullah Gjesheviq**, kryetari i komunës së Pejës, **Gazmend Muhaxheri** dhe kryetarja e Gucisë, **Anela Çekiç**, si dhe **Gazmir Raci** nga Sekretariati i përbashket teknik dhe bashkëpunëtorët e tjerë të projektit.



Është arritur në përfundimin se këto lloj projektsh përfaqësojnë përpjekje të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim të përmirësimit të statusit socio -ekonomik dhe promovimit të aseteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Pejë dhe Guci.



Ndiqni aktivitetet e projektit në faqen e dedikuar në [Facebook](https://www.facebook.com/cbc-mne-alb).



Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë

Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë në kuadër të Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri është organizuar me 18 Korrik të vitit 2021 në Podgoricë.



Në fillim të zbatimit të projekteve të kontraktuara përmes Thirrjes së Dytë në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 u theksua që nismat e vlefshme ndërkufitare që Mali i Zi dhe Republika e Shqipërisë kanë zbatuar bashkërisht që nga viti 2008, përmes Programit të financuar nga Bashkimi Evropian, tregojnë suksesin e konceptit të përgjithshëm të bashkëpunimit ndërkufitar, i cili është një stimul thelbësor për procesin e integritimit evropian.

Gjatë dhënies së certifikatave përfutuesve të Thirrjes së 2-të, Këshilltari i Kryenegociatorjes **Bojan Vujoqi** vuri në dukje se bashkëpunimi midis Malit të Zi dhe Shqipërisë është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e procesit të integritimit, ku mund të shkëmbehen përvoja dhe njohuri në fusha me rëndësi reciproke.



Ai kujtoi se përmes kësaj Thirrjeje, një numër i madh i organizatave dhe institucioneve partnere aplikuan me gjithsej 53 projekt-propozime në kuadër të dy prioritetet tematike, vlera e të cilave ishte 6 herë më e madhe se

fondet në dispozicion.

Aleksandar Marković, menaxher kontraktues në Drejtorinë e Financave dhe Kontraktimit për Asistencën e Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave dhe Mirëqenies Sociale të Malit të Zi, kujtoi se vlera totale e fondeve të alokuara përmes Thirrjes së Dytë është mbi 2.6 milion euro, që do të thotë se mbi 93% e fondeve të alokuara janë kontraktuar. "Në nivelin e Programit, mbi 5 milion euro mbështetje janë dhënë deri më tani për projekte në fushat e punësimit dhe përfshirjes sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore", theksoi Marković.



Ai gjithashtu njoftoi se së



shpejti do të publikohet Thirrja e Tretë për Projekt propozime në kuadër të këtij Programi, e cila është planifikuar të shpallet deri në fund të qershorit, në shumën totale prej 4.9 milion euro.

Zëvendës Shefja e Sektorit për Bashkëpunim në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi **Audrone Urbonaviqite** theksoi se përmes këtij programi të BE-së, Bashkimi Evropian aktualisht po

financon bashkëpunimin ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë me fonde në vlerë prej 10.7 milion euro, prej të cilave 2.6 milion euro janë kontraktuar sot për shtatë projekte të reja. Në periudhën e kaluar, ne kemi monitoruar me kujdes ndikimin që projektet e financuara nga BE kanë në komunitetet lokale dhe presim që projektet e reja të japin një kontribut shtesë në këtë drejtim. Procesi i mbrojtjes së mjedisit, trajtimi i ndryshimeve klimatike dhe problemeve socio-ekonomike, megjithëse sfidues, sjell përparim afatgjatë. Është vërtet inkurajuese që përparimi i dukshëm është bërë gjatë muajve të fundit përkundër sfidave të pandemisë COVID-19.



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, **Armand Skapi**, kujtoi se strukturat operative bashkëpunuan së bashku, në frymën e bashkëpunimit ndërkufitar në përgatitjen e programit, zgjedhjen e projekteve, si dhe sigurimin e zbatimit të Programit "Përpjekjet tona janë përqendruar tani në projekte dhe u takon përfutuesve të granteve të arrijnë atë që është premtuar në mënyrë që të mundësojnë arritjen e qëllimeve dhe indikatorëve të programit, dhe në fund të fundit të kenë një ndikim pozitiv në jetën e përditshme të komuniteteve," tha Skapi.



rezikut të katastrofave në zonën e programit.euros.

Aktivitetet e projektit kanë për qëllim fuqizimin e të rinjve, inkurajimin e përfshirjes sociale, përmirësimin e mundësive të punësimit për personat me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zvogëlimin e

»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë, Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian